


1828/2c

28-04-2026



Në bazë të neneve 11 dhe 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 2 pika j) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.28/2008), nenit 7 paragrafi 3 të Ligjit nr.04/L-010 për bashkëpunimin ndërkomunal (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.7/2011), si dhe nenit 13 pika i) të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dytë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 28.04.2026, merr këtë:

VENDIM NR.21/2026/KG

për dhënien e autorizimit kryetarit të komunës për fillimin e konsultimeve për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal

Neni 1

Me këtë vendim autorizohet kryetari i Komunës së Graçanicës, z. Novak Zhiviq (*Novak Živić*) për fillimin e konsultimeve për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal midis Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Zubin Potokut.

Neni 2


Gjithashtu kryetari i komunës autorizohet për përgatitjen e propozimit të marrëveshjes për bashkëpunimin ndërkomunal, në përputhje me Vendimin e Kuvendit të komunës për miratimin e nismës për bashkëpunimin ndërkomunal, si dhe kompetencat e parapara me legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Propozimi i marrëveshjes për bashkëpunimin ndërkomunal i përcillet Kuvendit të komunës për miratim, ndërsa hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit të tij.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević
Milan Dimitrijević